



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА  
PROGRAMI PËR MBËSHETJE PARLAMENTARE  
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME




Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC

Analiza e opinionit publik nr. 2/2026

# VËSHTRIM I KUVENDIT: PERCEPTIMI I QYTETARËVE PËR PUNËN E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT (2026)

AUTORË: ALEKSANDRA JOVEVSKA GJORGJEVIQ DHE JOANA TRENESKA



IMPLEMENTUAR NGA:





*Ky publikim është përpiluar në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PMP), projekt i Qeverisë së Zvicrës nën patronazhin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. PMP zbatohet nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci "Societas Civilis"- Shkup (IDSCS) dhe Qendra për Menaxhim me Ndryshime (QMN). Opinionet, pikëpamjet dhe përmbajtja e shprehur nuk pasqyrojnë pikëpamjet e projektit, donatorit dhe zbatuesit.*



# PËRMBAJTJA

<b>I.</b>	METODOLOGJIA	5
<b>II.</b>	KONTEKSTI POLITIK	5
<b>III.</b>	REZYME	7
<b>IV.</b>	INFORMIM PËR PUNËN E KUVENDIT	13
<b>V.</b>	KONTROLLI DHE MBIKËQYRJA E KUVENDIT MBI PUSHTETIN EKZEKUTIV	27
<b>VI.</b>	FUNKSIONET E KUVENDIT	33
<b>VII.</b>	PUBLIKU NË PUNËN E KUVENDIT	37
<b>VIII.</b>	KË PËRFAQËSOJNË DEPUTETËT NË KUVEND	49
<b>IX.</b>	DEBATI PARLAMENTAR	55
<b>X.</b>	REFORMA	61
<b>XI.</b>	VLERËSIMI MESATAR PËR PUNËN E KUVENDIT	65
<b>XII.</b>	KONTEKSTI POLITIK DHE BESIMI NË INSTITUCIONET	69
<b>XIII.</b>	SHPËRNDARJA DEMOGRAFIKE E TË ANKETUARVE	76

## IMPRESUM

**Titulli:** Analiza e opinionit publik nr. 2/26: Vështrim i Kuvendit: Perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (2026)

**Titulli i originalit:** Анализа на јавно мислење бр. 2/26: Поглед на Собрание: Перцепциите на граѓаните за работата на Собранието на Република Северна Македонија (2026)

**Botues:** Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup

**Autorë:** Aleksandra Jovevska Gjorgjeviq dhe Joana Treneska

**Redaktor:** Marko Troshanovski

**Përkthim nga maqedonishtja në shqip:** Vjosa Taipi

**Dizajni:** Dejan Kuzmanovski

**Shtypshkronja:** Rojal Art

**Vendi dhe viti i botimit**

Shkup, 2026

**Tirazhi**

30

# I. METODOLOGJIA

Në periudhën nga 27 shkurt deri më 10 mars 2026, Instituti për Demokraci «Societas Civilis» - Shkup, në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PMP), **realizoi anketë në terren me qëllim të hulumtimit më të mirë të perceptimit publik për punën e Kuvendit, cilësinë e jetës dhe besimin në institucionet e Maqedonisë së Veriut.** Anketa në terren u krye me një mostër prej 1002 të anketuar, të moshës mbi 18 vjeç në të gjithë vendin, nëpërmjet bisedës sy më sy. Pyetësori i përdorur për anketën është i disponueshëm si Aneksi I i analizës, ndërsa gabimi statistikor është  $\pm 3\%$ .

## II. KONTEKSTI POLITIK

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me Kushtetutën, është bartës i pushtetit legjislativ dhe ka 120 përfaqësues të zgjedhur në zgjedhje të drejtpërdrejta dhe proporcionale parlamentare për një mandat katërvjeçar. Përbërja aktuale u zgjodh në zgjedhjet e njëmbëdhjetë parlamentare, të mbajtura më 8 maj 2024, së bashku me raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale.

Mbajtja e zgjedhjeve ishte rezultat i një marrëveshjeje të arritur në një takim lidhës të mbajtur më 4 dhjetor 2023, me iniciativën e kryetarit të Kuvendit, Talat Xhaferi. Marrëveshja u arrit në kushte të polarizimit të fortë politik të shkaktuar nga ndryshimet kushtetuese të propozuara, në lidhje me përfshirjen e popullit bullgar në Preambulë dhe ndryshimet në nenet 49 dhe 78 të Kushtetutës – kusht për vazhdimin e negociatave me Bashkimin Evropian. Mbështetja për këto ndryshime erdhi nga shumica parlamentare e atëhershme dhe blloku opozitar shqiptar, ndërsa partitë e tjera opozitare kundërshtuan fuqishëm dhe kërkuan zgjedhje të parakohshme në vjeshtën e vitit 2023.

Procesi zgjedhor në maj 2024 u zhvillua në një atmosferë të qetë dhe të drejtë, pa parregullsi të konsiderueshme. Në zgjedhje morën pjesë 17 subjekte politike – 11 parti, 5 koalicione dhe një listë e pavarur, me gjithsej 84 lista të kandidatëve. Koalicioni «Maqedonia juaj» i udhëhequr nga VMRO-DPMNE fitoi shumicën e vendeve – gjithsej 58 vende, që është një rritje prej 14 vendesh në krahasim me përbërjen e mëparshme. Koalicioni «Për një të ardhme evropiane» i udhëhequr nga LSDM fitoi 18 vende (nga 28), ndërsa koalicioni «Fronti Evropian» i udhëhequr nga BDI gjithashtu fitoi 18 vende (nga 3). Opozita e bashkuar shqiptare “Vlen” mori 14 mandate parlamentare, Levica fitoi 6 (rritje prej 4 mandatesh), dhe Lëvizja ZNAM – Për Maqedoninë tonë me 6 deputetë – hyri në Kuvend si një subjekt i ri politik. Konkurrentët e tjerë nuk siguruan përfaqësim parlamentar.

Seanca konstituive e përbërjes së re të Kuvendit u mbajt më 28 maj 2024, në përputhje me Rregulloren e re të punës të miratuar më 20 nëntor 2023 nga përbërja e mëparshme parlamentare. Kjo rregullore e punës është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës të dialogut midis qeverisë dhe opozitës, të zhvilluar në kuadër të të ashtuquajturit proces "Jean Monnet". Shumica e re parlamentare numëronte 78 deputetë, të përbërë nga koalicioni «Maqedonia jote» i udhëhequr nga VMRO-DPMNE (58), koalicioni «Vlen (Vlen)» (14) dhe Lëvizja ZNAM (6). Opozita përbëhet nga 42 deputetë – koalicioni «Për një të ardhme evropiane» i udhëhequr nga LSDM-ja (18), «Fronti Evropian» i udhëhequr nga BDI-ja (18) dhe Partia Levica (6).

Gjatë vitit 2025, ka pasur ndryshime të rëndësishme brenda shumicës parlamentare. Pas tërheqjes së Aleancës për Shqiptarët të udhëhequr nga Arben Taravari nga koalicioni qeveritar, pesë deputetë u larguan nga grupi parlamentar i koalicionit Vlen. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, shumica parlamentare u ul nga 78 në 73 deputetë. Pas zgjedhjeve lokale të mbajtura në tetor 2025, tre deputetë nga shumica parlamentare u larguan nga zyra e tyre parlamentare pasi u zgjodhën kryetarë të komunave. Vendet e tyre në Kuvend u plotësuan me kandidatët e ardhshëm nga listat e kandidatëve, në përputhje me procedurat ligjore.

---

## III. REZYME

Sondazhi i kryer në vitin 2026 tregon se perceptimi i qytetarëve për punën e Kuvendit shënon një hap të lehtë pozitiv në krahasim me tre vitet e fundit. Kënaqësia me punën e Kuvendit vlerësohet me një rezultat mesatar prej 2.7 (në shkallën 1 – më keq deri në 5 – më mirë), që është vazhdimësi e trendit pozitiv të rritjes të vërejtur në tre vitet e fundit, por është ende nën rezultatin mesatar.

### ■ INFORMIMI PËR PUNËN E KUVENDIT

Temat më të paharrueshme nga puna e Kuvendit për vitin e kaluar janë debati mbikëqyrës në Komisionin e Përhershëm Anketues për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe çështjet buxhetore, që tregon se këto tema kishin shikueshmërinë më të madhe te publiku. Qytetarët ende informohen më shpesh përmes stacioneve televizive private, por me një trend në rënie në kurriz të internetit dhe rrjeteve sociale, veçanërisht në mesin e brezave të rinj. Kanalet zyrtare të Kuvendit, përkatësisht Kanali Televiziv Parlamentar dhe faqja e internetit, ende kanë një shtrirje relativisht të kufizuar, por kanë dukshmëri të qëndrueshme dhe vlerësime pozitive midis atyre që i përdorin ato. Njohja me përmbajtjen e re të Kanalit Televiziv Parlamentar mbetet e ulët, por është më mirë se në vitin 2024, ndërsa te audienca që ndjek këto përmbajtje dominon perceptimi pozitiv. Në mënyrë të ngjashme, megjithëse faqja e internetit e Kuvendit përdoret nga një pjesë e vogël e qytetarëve, përdoruesit në përgjithësi janë të kënaqur me funksionalitetin e saj.

### ■ KONTROLLI DHE MBIKËQYRJA E KUVENDIT MBI PUSHTETIN EKZEKUTIV

Te qytetarët mbizotëron perceptimi se Qeveria ka më shumë ndikim mbi Kuvendin sesa që Kuvendi ka kontroll efektiv mbi pushtetin ekzekutiv. Monitorimi i pyetjeve të deputetëve është i kufizuar, por te qytetarët që ndjekin këto seanca dominon pikëpamja se ato kanë rëndësi për mbikëqyrje mbi ministritë, sigurimin e llogaridhënies dhe informimin e publikut. Në të njëjtën kohë, njohja e mekanizmave të tjerë mbikëqyrës të Kuvendit është e ulët, megjithëse rastet individuale, siç është debati mbikëqyrës në Komisionin e Përhershëm Anketues për Tragjedinë në Koçan, është mbajtur mend nga publiku. Te qytetarët që identifikojnë një rast konkret mbikëqyrjeje, mbizotëron vlerësimi se Kuvendi e ka përmbushur pjesërisht rolin e tij mbikëqyrës, gjë që tregon një perceptim për ekzistencën e funksionit mbikëqyrës, por me efikasitet të kufizuar.

## ■ **FUNKSIONET E KUVENDIT**

Qytetarët si funksionet më të rëndësishme të Kuvendit i identifikojnë miratimin e ligjeve cilësore, mbikëqyrjen ndaj Qeverisë dhe ndjekjen e zbatimit të ligjeve dhe politikave. Megjithatë, perceptimi i tyre është se këto funksione kryesore përmbushen vetëm me sukses të moderuar. Në të kundërt, ata mendojnë se Kuvendi më së shumti e përmbush funksionin e miratimit të sa më shumë ligjeve dhe ndryshimeve ligjore, megjithëse pikërisht këtë e vlerësojnë si më pak të rëndësishme. Kjo tregon një hendek midis pritshmërive të qytetarëve dhe perceptimit të tyre se si Kuvendi në praktikë kryen funksionet e tij themelore.

## ■ **PUBLIKU NË PUNËN E KUVENDIT**

Përceptimet e qytetarëve për publikun në punën e Kuvendit tregojnë për një hapje të kufizuar, nivel të ulët të komunikimit të drejtpërdrejtë me deputetët dhe vetëdije të pamjaftueshme për mekanizmat ekzistues për pjesëmarrje. Shumica e qytetarëve besojnë se Kuvendi nuk është mjaft i hapur për publikun, ndërsa pjesa më e madhe nuk e dinë se kush është deputeti i tyre, nuk kanë kontaktuar kurrë një deputet dhe nuk janë të njohur me zyrat e deputetëve ose Karvanin Parlamentar. Në të njëjtën kohë, ata që kanë kontaktuar ose kanë vizituar zyrën lokale kanë një përvojë pozitive, gjë që tregon se mekanizmat ekzistues kanë potencial, por shikueshmëri dhe përdorim të pamjaftueshëm. Qytetarët shprehin qartë pritshmërinë e tyre për komunikim më të drejtpërdrejtë, më të arritshëm dhe më aktiv me deputetët, veçanërisht përmes takimeve në vende publike dhe paraqitjeve publike, gjë që tregon nevojën për përafrim më të fortë të Kuvendit me qytetarët.

## ■ **KË PËRFAQËSOJNË DEPUTETËT NË KUVEND**

Ekziston një perceptim i vazhdueshëm se deputetët kryesisht përfaqësojnë interesat e tyre personale dhe interesat e qarqeve partiake, ndërsa interesat e qytetarëve ngelin në margjina. Deputetët perceptohen si jo mjaft aktivë në avokimin e çështjeve lokale ose personale me interes për qytetarët. Komuniteti i biznesit shpesh përmendet si një grup, interesat e të cilit përfaqësohen, por perceptimet se sa në mënyrë efektive Kuvendi merr parasysh nevojat e sektorit privat më shpesh mbeten të moderuara.

## ■ **DEBATI PARLAMENTAR**

Qytetarët perceptojnë se konfrontimi mbizotëron në debatet parlamentare në vend të bashkëpunimit midis qeverisë dhe opozitës. Ekziston një përqindje e vogël e të anketuarve që besojnë se argumentet e kampit të kundërt merren parasysh, ndërkaq ekziston gjithashtu një perceptim se gatishmëria për kompromis midis palëve është e kufizuar, veçanërisht midis maqedonasve etnikë. Në të njëjtën kohë, mbetet përshtypja se deputetët shpesh përdorin fjalë nënçmuese dhe degraduese në seancat parlamentare.

---

## ■ REFORMA

Qytetarët në një masë të konsiderueshme e mbështesin idenë për formimin e grupeve shumë-partiake në Kuvend, veçanërisht për çështje që lidhen me të rinjtë, anti-korrupsionin, të papunët, personat me aftësi të kufizuara dhe prindërit vetë ushqyes. Ka gjithashtu një interes të dukshëm për tema të tilla si mbrojtja e mjedisit, ndihma sociale dhe mbështetja e grave, gjë që tregon pritshmëri që nisma të tilla të përqendrohen në çështje me interes më të gjerë publik dhe shoqëror.

## ■ KONTEKSTI POLITIK DHE BESIMI NË INSTITUCIONET

Megjithëse qytetarët shohin një përmirësim të lehtë në perceptimin e drejtimit në të cilin po lëviz vendi, kënaqësia e pamjaftueshme vazhdon të mbizotërojë ndërsa besimi në institucione mbetet i moderuar. Qytetarët që kanë besim të ulët në Kuvend më së shpeshti shoqërohen me perceptime të profesionalizmit të pamjaftueshëm, pandershmërisë, korrupsionit dhe përqendrimit të pamjaftueshëm në interesin publik, ndërsa pritjet e qytetarëve vazhdojnë të synojnë llogaridhënie më të madhe, ndershmëri, transparencë dhe punë në interes të qytetarëve. Në të njëjtën kohë, qytetarët e perceptojnë opozitën si relativisht të dobët, rolin e Kuvendit në integrimin evropian si jo mjaftueshëm të qartë, dhe aftësinë e saj për t'iu përgjigjur sfidave që lidhen me sigurinë kombëtare si kryesisht të moderuar, por me një dozë të theksuar rezervash.



# IV.

## INFORMIMI PËR PUNËN E KUVENDIT





## IV. INFORMIMI PËR PUNËN E KUVENDIT

Në pyetjen “Për çfarë do ta kujtoni vitin 2025 në Kuvend?”, qytetarët në mënyrë të theksuar veçuan debatin mbikëqyrës në Komisionin e përhershëm anketues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut lidhur me tragjedinë në Koçan, e përmendur nga 31% e të anketuarve. Fakti që ky debat mbikëqyrës është në mënyrë bindëse më i përmenduri tregon se qytetarët ndoqën punën e Kuvendit për këtë çështje dhe e identifikuan atë si një nga momentet më të dukshme në vitin 2025. Më pas vijojnë: debati për Propozim-Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2026, i përmendur nga 25% e të anketuarve; dëgjimi publik me temë “Mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve nga ndikimet e dëmshme dhe pasojat e duhanpirjes”, i përmendur nga 15% e qytetarëve; interpelanca ndaj Pançe Toshkovskit me 14%; debati lidhur me raportin e Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut me 13%; ndërsa Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit për vitin 2025 dhe Propozim - ligji për Këshillin Gjyqësor u përmendën nga 12% e të anketuarve secili (Grafiku 1). Këto përgjigje tregojnë se publiku më së shumti mban mend tema që lidhen drejtpërdrejt me punën e pushtetit dhe financave, përkatësisht proceset e mbajtjes së ekzekutivit përgjegjës dhe miratimin e buxhetit, të cilat janë elemente kyçe në funksionimin e sistemit demokratik.


Grafiku 1. Për se do të mbani mend Kuvendin gjatë vitit 2025? (%)



## 14 VËSHTRIM I KUVENDIT: PERCEPTIMI I QYTETARËVE PËR PUNËN E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT


Qytetarët që dhanë një përgjigje specifike, në mënyrë plotësuese u pyetën në lidhje me perceptimin e tyre se sa të kënaqur janë me mënyrën se si Kuvendi ka përmbushur funksionin e tij në atë rast të veçantë. Mund të theksohet këtu se perceptimi ndryshon në varësi të temës, por kënaqësia e moderuar ose e ulët mbizotëron në disa nga rastet më të dukshme. Në debatin mbikëqyrës në Komisionin e Përhershëm Anketues për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në lidhje me tragjedinë në Koçan, 42% e të anketuarve dhanë një vlerësim prej 1, gjë që tregon një perceptim kritik të veprimit të Kuvendit në këtë rast. Nga ana tjetër, kënaqësia më e madhe është shprehur në Propozim ligjin për lëshimin e kuponëve me vlerë, ku shumica e të anketuarve kanë dhënë nota të larta. Në raste të tjera, siç është debati për Propozim -buxhetin për vitin 2026, debati publik për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve nga efektet e dëmshme të pirjes së duhanit dhe debati për Raportin e Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut, më së shpeshti përfaqësohet rezultati mesatar, gjë që tregon një vlerësim më të përmbajtur dhe të moderuar të qytetarëve për punën e Kuvendit (Grafiku 1.1).

Grafiku 1.1 (Qytetarët që u përgjigjën me një rast konkret në pyetjen e mëparshme) Në shkallën nga 1 – nuk jam aspak i/e kënaqur deri në 5 – shumë i/e kënaqur, sa i/e kënaqur jeni me mënyrën se si Kuvendi ka përmbushur funksionin e tij në këtë rast të veçantë (%)




Të anketuarit u pyetën gjithashtu për kënaqësinë e tyre të përgjithshme me punën e Kuvendit gjatë vitit të kaluar. Në shkallën nga 1 deri në 5, ku 1 do të thotë se nuk janë aspak të kënaqur, dhe 5 se janë shumë të kënaqur, qytetarët e kanë vlerësuar punën e Kuvendit me notën mesatare 2.7. Krahasuar me matjet e mëparshme, kjo paraqet një përmirësim të lehtë të perceptimit, duke pasur parasysh se në sondazhin e kryer një vit më parë rezultati mesatar ishte 2.5, ndërsa në vitin 2024 ishte 2.3. Megjithatë, përkundër kësaj rritje graduale, rezultati i performancës së Kuvendit mbetet nën mesataren në shkallë, duke treguar se kënaqësia e përgjithshme midis qytetarëve është ende relativisht e ulët (Grafiku 2).

Grafiku 2. Nota mesatare e kënaqësisë së qytetarëve me punën e Kuvendit, në shkallën 1 do të thotë se nuk janë aspak të kënaqur, dhe 5 se janë shumë të kënaqur




Nëse perceptimet e të anketuarve për punën e Kuvendit në tre vitet e fundit merren në konsideratë në mënyrë më të detajuar, mund të vërehet një zhvendosje graduale drejt vlerësimeve më të moderuara dhe më pozitive. Përqindja e qytetarëve që «nuk janë aspak të kënaqur» bie nga 34% në vitin 2024, në 25% në vitin 2025 dhe 18% në vitin 2026. Në të njëjtën kohë, pjesa e atyre që dhanë nota më të larta, përkatësisht 4 dhe 5, u rrit nga një total prej 15% në vitin vitin 2024, në 20% në vitin 2025 dhe 23% në vitin 2026. Megjithatë, pavarësisht këtij përparimi, pjesa më e madhe e të anketuarve vazhdojnë të përqendrohen rreth notës mesatare 3, gjë që tregon një perceptim të moderuar dhe jo qartësisht pozitiv për punën e Kuvendit. (Grafiku 2.1.).

### VLERËSIMI I CILËSISË PËR BIZNESIN E KUVENDIT QERSHOR – DHJETOR 2026, NË SHKALLËN 1 DERI NË 5




Grafiku 2.1 Në shkallën nga 1 deri në 5 (ku 1 do të thotë se nuk jeni aspak i kënaqur dhe 5 se jeni shumë të kënaqur), sa jeni të kënaqur me punën e Kuvendit në vitin e kaluar? (%)




Sa i përket burimeve nga të cilat qytetarët informohen më shpesh për punën e Kuvendit, edhe në vitin 2026 stacionet televizive private mbeten më të përfaqësuara, megjithëse pjesëmarrja e tyre është ulur në krahasim me vitin e kaluar – nga 34% në vitin 2025 në 25% në vitin 2026. Njëkohësisht, vërehet një rritje në informimin përmes internetit dhe rrjeteve sociale, të cilat rriten nga 18% në 22%, ndërsa portalet e lajmeve në internet mbeten në të njëjtin nivel prej 17%. Kur bëhet fjalë për burimet zyrtare të informimit të Kuvendit – kanalin televiziv të Kuvendit dhe faqen zyrtare të Kuvendit – megjithëse përfaqësimi i tyre mbetet relativisht i ulët, megjithatë vërehet stabilitet në përdorimin e këtyre mekanizmeve dhe një lëvizje e lehtë përpara. Kanali televiziv i Kuvendit si burim kryesor informacioni është përmendur nga 6% e qytetarëve në vitin 2026, çka përfaqëson një stabilitet të audiencës krahasuar me vitin 2025, kur ishte përmendur nga 5% e qytetarëve. Në mënyrë të ngjashme, faqja e internetit e Kuvendit, nga 1% në vitin 2025 në 2% në vitin 2026. Megjithëse këto kanale ende nuk janë ndër burimet dominuese të informimit, të dhënat tregojnë për një dukshmëri të qëndrueshme me potencial për forcim të mëtejshëm si burime të drejtpërdrejta informacioni për punën e Kuvendit. Këto gjetje tregojnë se, edhe më tej, rol dominues në informimin për punën e Kuvendit kanë mediat me shtrirje më të gjerë, ndërsa kanalet zyrtare të Kuvendit ende kanë një rol më modest, por të rëndësishëm. Vlera e tyre qëndron veçanërisht në faktin se ofrojnë informacione të drejtpërdrejta dhe të pa-filtruara për punën parlamentare, gjë që është e rëndësishme nga këndvështrimi i transparencës dhe i një pasqyre të drejtpërdrejtë mbi proceset institucionale. Në këtë kontekst, megjithëse përdorimi i tyre mbetet i kufizuar, ruajtja e një dukshmërie të qëndrueshme dhe rritja e lehtë të disa prej këtyre kanaleve përbën një bazë pozitive për forcimin e mëtejshëm të tyre dhe për ndërtimin gradual të një besimi dhe interesi më të madh të publiku. Njëkohësisht, vërehet edhe një rënie e lehtë në përqindjen e qytetarëve që nuk dëshirojnë të marrin informacione për punën e Kuvendit, nga 14% në 12%, çka mund të interpretohet si një sinjal pozitiv për një rritje të moderuar të interesit për zhvillimet parlamentare (Grafiku 3).

Chart 3. If you want to receive information about the work of the Parliament, which source for information do you use the most? (%)




Të dhënat tregojnë dallime të qarta në burimet e informacionit për punën e Kuvendit në varësi të moshës së qytetarëve. Te të anketuarit më të rinj, të moshës 18 deri në 29 vjeç, burimet më të përhapura janë interneti dhe rrjetet sociale, të cilat i përdorin 35% e të anketuarve, si dhe portalet e lajmeve në internet me 20%, ndërsa televizionet private janë përmendur vetëm nga 9%. Me rritjen e moshës, roli i televizionit rritet ndjeshëm, kështu që te qytetarët e moshës 60 vjeç e më shumë, televizionet private janë burimi bindshëm dominues i informimit, të përmendura nga 47% e të anketuarve. Në këtë grup-moshë është më e lartë edhe përfaqësimi i shërbimit publik, i cili përdoret nga 12% e qytetarëve. Nga ana tjetër, burimet digjitale janë më të pranishme te të rinjtë dhe qytetarët e moshës së mesme, ndërsa përdorimi i tyre bie gradualisht te grup-moshat më të vjetra. Kanali televiziv i Kuvendit shënon një përfaqësim disi më të madh te grup-moshat më të vjetra, veçanërisht te të anketuarit mbi 50 vjeç, çka mund të tregojë një gatishmëri më të madhe të kësaj audience për të ndjekur përmbajtje parlamentare në transmetim të drejtpërdrejtë. Interesant është edhe fakti që mosinteresi për informacione rreth Kuvendit është më i theksuar te më të rinjtë, ku 21% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk dëshirojnë të marrin informacione ose se tema nuk i intereson, ndërsa kjo përqindje është më e ulëta te të anketuarit më të moshuar (7%). (Grafiku 3.1.).

Grafiku 3.1 Burimet e informimit për punën e Kuvendit sipas grup-moshës (%)




Nga janari 2024, Kanali Televiziv i Kuvendit transmeton përmbajtje të pasuruar me programe dhe emisione të reja që prodhohen në Studion e televizionit të Kuvendit. Lidhur me këtë, qytetarët u pyetën nëse ishin njohur me programin, përmbajtjen dhe emisionet e reja që transmetohen në TV Kanalin e Kuvendit, përveç transmetimit të seancave. Gjetjet tregojnë se niveli i njohjes është i njëjtë me vitin e kaluar, 2025, dhe është relativisht i ulët, por në krahasim me vitin 2024 megjithatë vërehet një përmirësim i caktuar. Ndërsa në vitin 2024, 68% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk janë aspak të njohur me këto përmbajtje, në vitet 2025 dhe 2026 kjo përqindje është 61%. Njëkohësisht, përqindja e atyre që janë plotësisht ose pjesërisht të njohur është disi më e lartë se në vitin 2024, çka tregon një rritje graduale të dukshmërisë së kësaj oferte programore. Megjithatë, duke pasur parasysh se shumica e qytetarëve ende nuk janë të njohur me këto përmbajtje, mbetet hapësirë për promovimin e mëtejshëm të tyre dhe afrimin me publikun më të gjerë (Grafiku 4).

Chart 4. Are you familiar with the new programme, content and shows that is broadcasted on the Parliamentary TV channel since January 2024, in addition to the broadcast of parliamentary sessions? (%)




Qytetarët që deklaruan se ishin plotësisht ose pjesërisht të njohur me përmbajtjen e re të kanalit televiziv të Kuvendit u pyetën gjithashtu nëse ishin të kënaqur me përmbajtjen e ofruar nga ky kanal. Gjetjet tregojnë se edhe në vitin 2026 mbizotëron një perceptim pozitiv, ku pjesa më e madhe e të anketuarve kanë shprehur se janë disi të kënaqur me përmbajtjen. Në të njëjtën kohë, ka një rritje të pjesës së qytetarëve që janë shumë të kënaqur – nga 6% në vitin 2024, 8% në vitin 2025, në 12% në vitin 2026, gjë që tregon forcimin e vlerësimeve pozitive në mesin e audiencës që ndjek këto përmbajtje. Njëkohësisht, përqindja e të pakënaqurve është më e ulët krahasuar me vitin 2024, kur ishte 16%, çka tregon edhe më tej një perceptim më të favorshëm për ofertën programore të kanalit televiziv të Kuvendit të ata qytetarë që janë të njohur me të (Grafiku 5).

Grafiku 5. (Qytetarët që janë plotësisht ose pjesërisht të njohur me përmbajtjet e reja që transmetohen në kanal televiziv të Kuvendit u pyetën: “A jeni të kënaqur me përmbajtjen që ofron Kanali Televiziv i Kuvendit?” (%)




Nëse shikueshmëria e përmbajtjeve të kanalit televiziv të Kuvendit analizohet sipas grup-moshave, në përgjithësi përmbajtja më e ndjekur janë lajmet, ku interesi për to është veçanërisht i theksuar te të anketuarit më të moshuar, sidomos te ata të moshës 50 vjeç e më shumë. Intervistat, ndërkohë, shënojnë një shikueshmëri më të konsiderueshme midis të rinjve dhe të anketuarve të moshës 30 deri në 39 vjeç. Thesari parlamentar ka një përhapje më të balancuar, por gjithsesi më të moderuar ndër grup-moshat e ndryshme, ndërsa përmbledhja legjislative mbetet ndër përmbajtjet më pak të ndjekura në të gjitha grupet. (Grafiku 6). Përgjigjet e tilla tregojnë dallime në interesat dhe zakonet e monitorimit të përmbajtjes së programimit të kanalit televiziv parlamentar në varësi të moshës.

Grafiku 6. (Qytetarët që nuk janë plotësisht ose pjesërisht të njohur me përmbajtjen e re të transmetuar në kanal televiziv të Kuvendit) u pyetën: Cilën nga përmbajtjet e reja në Kanal e Kuvendit e ndiqni më shpesh? (%)




Sa i përket përmbajtjeve që qytetarët do të dëshironin të shihnin në kanal e Kuvendit, interesi më i madh është për interpretimet e ekspertëve mbi ligjet e miratuara dhe ndryshimet ligjore, të cilat i kanë përmendur pothuajse një e treta e të anketuarve (30%). Më pas vijnë përmbajtjet edukative për procesin legjislativ dhe punën e Kuvendit, si dhe debatet politike për tema nga puna parlamentare, me nga 22%, si dhe vizitat në terren të komisioneve parlamentare me 19%. Ka gjithashtu interes të dukshëm për përmbajtje promovuese për mundësitë e përfshirjes së qytetarëve në punën e Kuvendit dhe emisionet kontaktuese, të cilat u përmendën nga 18% e të anketuarve. Këto përgjigje tregojnë se qytetarët kanë interesin më të madh për përmbajtje që do t'u ndihmojnë të kuptojnë më mirë punën parlamentare, procesin legjislativ dhe mundësitë për informim dhe përfshirje të drejtpërdrejtë. (Grafiku 7).

Grafiku 7. Çfarë përmbajtje dëshironi të shikoni në kanal e Kuvendit? (%)




Nëse preferencat për përmbajtjet që qytetarët do të dëshironin të shihnin në kanalën e Kuvendit analizohen sipas grup-moshave, mund të vërehet se interpretimet e ekspertëve për ligjet e miratuara dhe ndryshimet ligjore janë përmbajtja më e kërkuar në pothuajse të gjitha kategoritë e moshës, veçanërisht të të anketuarit mbi 30 vjeç. Përmbajtja edukative mbi procesin legjislativ dhe punën e Kuvendit gjithashtu përmendet shumë midis të gjitha grupeve, me interes disi më të lartë midis të rinjve dhe njerëzve të moshës 30 deri në 39 vjeç. Debatet politike mbi tema të punës parlamentare përfaqësohen relativisht në mënyrë të barabartë, por janë veçanërisht tërheqëse për grupin më të vjetër të të anketuarve. Vizitat në terren të komisioneve parlamentare kanë interesin më të madh tek qytetarët e moshës 50 deri në 59 vjeç, ndërsa përmbajtja promovuese për mundësitë e përfshirjes së qytetarëve në punën e Kuvendit është më interesante për të anketuarit e moshës 40 deri në 59 vjeç. Përgjigjet e tilla sugjerojnë se, pavarësisht dallimeve të caktuara në moshë, qytetarët në të gjitha grup-moshat tregojnë interes për përmbajtjen që ofron shpjegim, kontekst dhe kuptueshmëri më të madhe të punës parlamentare (Grafiku 7.1).

Grafiku 7.1 Çfarë përmbajtje dëshironi të shikoni në kanalën televiziv të Kuvendit: Katër përmbajtjet më të njohura sipas grup moshës. (%)




Sa i përket përdorimit të faqes së internetit të Kuvendit për marrjen e informacionit, në vitin 2026 nuk vërehen ndryshime të rëndësishme krahasuar me periudhën e mëparshme. Gjegjësisht, 11% e qytetarëve deklaruan se kishin përdorur ndonjëherë faqen e internetit të Kuvendit, ndërsa 89% u përgjigjën se nuk e kishin përdorur kurrë. Krahasuar me vitin 2024 dhe 2025, kur kjo përqindje ishte 10%, mund të vërehet stabiliteti relativ i madhësisë së audiencës në përdorimin e këtij kanali zyrtar. Kjo tregon se faqja e internetit e Kuvendit vazhdon të ketë shtrirje të kufizuar në mesin e publikut të gjerë, por se ka hapësirë për promovimin e mëtejshëm dhe promovim më të madh si një burim përkatës informimi mbi punën parlamentare (Grafiku 8).

Grafiku 8. A keni përdorur ndonjëherë ueb faqen zyrtare të Kuvendit për të marrë informacion? (%)




Nga qytetarët që e kanë përdorur faqen e internetit të Kuvendit, pjesa më e madhe edhe në vitin 2026 kanë deklaruar se janë disi të kënaqur me dobishmërinë dhe funksionalitetin e saj, ku kjo përqindje arrin në 74%. Në të njëjtën kohë, ka një rritje të mëtejshme të përqindjes së atyre që janë shumë të kënaqur – nga 12% në vitin 2024, në 16% në vitin 2025 dhe 19% në vitin 2026. Në të njëjtën kohë, pjesa e të pakënaqurve është më e ulëta krahasuar me dy vitet e mëparshme dhe është 7%. Këto gjetje tregojnë një përvojë përdoruesi kryesisht pozitive të qytetarët që e kanë vizituar faqen e internetit, si dhe një përmirësim gradual të perceptimit për dobishmërinë dhe funksionalitetin e saj (Grafiku 9).

Grafiku 9. Nëse keni përdorur ndonjëherë faqen zyrtare të Kuvendit, sa jeni të kënaqur me dobinë dhe funksionalitetin e saj? (%)



Sa i përket përmbajtjeve për të cilat qytetarët më së shpeshti e vizitojnë ose do ta vizitonin faqen e internetit të Kuvendit, interesi më i madh është për mundësinë për t'u shtruar pyetje deputetëve, gjë që është përmendur nga 21% e të anketuarve. Vijnë debatet publike me 19%, si dhe mundësitë për komunikim me deputetët dhe fjalimet e deputetëve, me 18% secili. Ekziston një interes i dukshëm edhe për përmbajtje edukative mbi rolin dhe punën e Kuvendit, si dhe për informacione mbi votimet e deputetëve për pika të caktuara, të cilat janë veçuar nga 14% e të anketuarve secila. Këto përgjigje tregojnë se qytetarët kanë interesin më të madh për përmbajtjen që lejon ndërveprim më të madh, këqyrje në punën e deputetëve dhe kuptim më të mirë të proceseve parlamentare (Grafiku 10).

Grafiku 10. Për çfarë përmbajtjeje vizitoni më shpesh ose për çfarë do të vizitonit ueb faqen e Kuvendit? (%)







# KONTROLLI DHE MBIKËQYRJA E KUVENDIT MBI QEVERINË






## V. KONTROLLI DHE MBIKËQYRJA E KUVENDIT MBI QEVERINË


Perceptimi i qytetarëve është se Qeveria ka më shumë kontroll mbi Kuvendin sesa Kuvendi kontrollon Qeverinë, sipas kompetencës së tij kushtetuese. Në shkallën nga 1, që do të thotë se Qeveria ka kontroll të plotë mbi Kuvendin, deri në 7, që do të thotë se Kuvendi ka kontroll të plotë mbi Qeverinë, shumica e të anketuarve janë të pozicionuar drejt vlerave më të ulëta të shkallës. Kështu, 21% besojnë se Qeveria ka kontroll të plotë mbi Kuvendin, ndërsa 11% të tjerë kanë zgjedhur notën 2. Në të kundërt, vetëm 3% e të anketuarve besojnë se Kuvendi ka kontroll të plotë mbi Qeverinë, ndërsa 4% zgjedhën notën 6. Përgjigjja më e shpeshtë është nota 4, e përmendur nga 30% e qytetarëve, çka tregon se një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve nuk perceptojnë një dominim të qartë të njëres prej dy institucioneve, megjithëse shpërndarja e përgjigjeve mbetet ende më e prirë drejt perceptimit se Qeveria ka ndikim më të madh. Në krahasim me dy vitet e mëparshme, nuk vërehen ndryshime të mëdha në qëndrimet e qytetarëve, gjë që tregon një perceptim relativisht të qëndrueshëm se Kuvendi ende nuk perceptohet si një institucion që ka kontroll më të fortë mbi pushtetin ekzekutiv (Grafiku 11).

Grafiku 11. Në çfarë shkalle e kontrollojnë Kuvendi Qeverinë, përkatësisht Qeveria mbi Kuvendin? (%)




Lidhur me pyetjet e deputetëve që janë një nga instrumentet e Kuvendit për të kontrolluar punën e ministrive dhe pushtetit ekzekutiv në përgjithësi, 7% e qytetarëve deklaruan se shpesh i ndjekin, ndërsa 36% thanë se rrallë e bëjnë këtë. Megjithatë, më shumë se gjysma, përkatësisht 57%, deklaruan se nuk i ndjekin kurrë seancat për pyetje të deputetëve. Në krahasim me vitin 2025, vërehet një rritje e lehtë te ata që i ndjekin shpesh këto seanca, por ende mbizotëron një nivel i ulët i ndjekjes së rregullt (Grafiku 12).

Grafiku 12. A i ndiqni seancat për pyetje të deputetëve në Kuvend? (%)




Qytetarët që ndjekin seancat për pyetje të deputetëve më shpesh ose ndonjëherë u pyetën gjithashtu për perceptimin e tyre në lidhje me funksionalitetin e këtij mjete për mbikëqyrjen e pushtetit ekzekutiv. Shumica e tyre, plotësisht ose pjesërisht, pajtohen se pyetjet e deputetëve lejojnë mbikëqyrjen e punës së ministrave (68%), kanë ndikim në sigurimin e llogaridhënies së institucioneve (64%) dhe informojnë qytetarët për punën e Qeverisë dhe institucioneve të tjera (63%). Gjithashtu, shumica e të anketuarve besojnë se pyetjet e deputetëve përdoren gjithashtu për të kritikuar Qeverinë dhe institucionet e tjera (59%). Vetëm në pretendimin se pyetjet parlamentare përdoren për të reklamuar Qeverinë dhe institucionet e tjera, qëndrimet janë të ndara, me një pjesë të barabartë të të anketuarve që pjesërisht pajtohen dhe pjesërisht nuk pajtohen (29% secila). Këto gjetje sugjerojnë që qytetarët që ndjekin pyetjet e deputetëve kryesisht i identifikojnë ato si një mekanizëm për mbikëqyrje, llogaridhënie dhe informim, dhe më pak si një mjet promovimi (Grafiku 13).

Grafiku 13. (Për qytetarët që u përgjigjën se shpesh ose rrallë ndjekin pyetjet e deputetëve) Në çfarë mase pajtoheni me secilën nga deklaratat e lexuara në lidhje me pyetjet e deputetëve, si një mjet për mbikëqyrjen e pushtetit ekzekutiv. (%)




Duke marrë parasysh edhe mekanizmat e tjerë që i qëndrojnë në dispozicion Kuvendit për mbikëqyrjen e pushtetit ekzekutiv, të anketuarit u pyetën gjithashtu nëse kujtojnë ndonjë mbikëqyrje tjetër që gjatë vitit të kaluar Kuvendi ka ndërmarrë për kontrollin e Qeverisë dhe institucioneve të tjera. Shumica e qytetarëve, përkatësisht 91%, u përgjigjën se nuk e mbanin mend një rast të tillë. Një pjesë e vogël e të anketuarve, nga ana tjetër, theksuan shembuj specifikë, ku më së shpeshti përmenden diskutimi për tragjedinë në Koçan (3%), interpelanca për Ljupço Koçevskin (2%) dhe interpelanca për Pançe Toshkovski (2%), ndërsa 5% iu referuan një lloji tjetër të mbikëqyrjes (Grafiku 14). Duke pasur parasysh se interpelanca ndaj Ljupço Kocevskit ishte paralajmëruar dhe e pranishme në hapësirën publike dhe mediatike, edhe pse procedura nuk u realizua deri në fund, ajo megjithatë ka mbetur e mbajtur mend nga një pjesë e qytetarëve si një përpjekje për mbikëqyrje parlamentare. Kjo tregon se perceptimet e qytetarëve për mbikëqyrjen parlamentare formësohen edhe nga dukshmëria publike dhe mediatike e iniciativave të caktuara, e jo vetëm përmes procedurave të zbatuara formalisht dhe rezultatit institucional. Këto gjetje tregojnë se, pavarësisht pranisë së rasteve individuale të identifikueshme, mekanizmat e tjerë mbikëqyrës të Kuvendit kanë njohje të kufizuar në publik, që mund të nënkuptojë se qytetarët ose nuk janë të informuar sa duhet për to, ose nuk i njohin debatet dhe procedurat specifike si pjesë integrale e funksionit mbikëqyrës të Kuvendit. Kjo është veçanërisht e dukshme nëse merret parasysh se më parë madje 31% e të anketuarve e veçuan seancën mbikëqyrëse në Komisionin e përhershëm anketues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të lidhur me tragjedinë në Koçan, si ngjarjen për të cilën do ta kujtojnë vitin 2025 në Kuvend, ndërsa këtu vetëm një pjesë e vogël e tyre e përmendin spontanisht si shembull të një mekanizmi mbikëqyrës. Kjo tregon se disa raste mbeten të ngulitura në kujtesën e publikut, por jo gjithmonë njihen qartë si pjesë e funksionit mbikëqyrës të Kuvendit.

Grafiku 14. Përveç pyetjeve të deputetëve, a ju kujtohet ndonjë mbikëqyrje tjetër që Kuvendi ndërmoi vitin e kaluar për të kontrolluar Qeverinë dhe institucionet? (%)



Nga qytetarët që kanë përmendur një rast konkret mbikëqyrjeje nga ana e Kuvendit, 22% mendojnë se Kuvendi e ka përmbushur plotësisht rolin e tij mbikëqyrës, ndërsa gjysma e të anketuarve, përkatësisht 47%, besojnë se kjo është bërë vetëm deri në një masë të caktuar. Nga ana tjetër, 32% janë të mendimit se Kuvendi nuk e ka përmbushur rolin e tij të kontrollit mbi Qeverinë dhe institucionet. Këto gjetje tregojnë se perceptimi mbizotëron midis qytetarëve që njohin raste specifike të mbikëqyrjes ku Kuvendi kishte një rol mbikëqyrës të caktuar, por jo gjithmonë plotësisht efektiv (Grafiku 15).

Grafiku 15. (Qytetarët që kanë përmendur një rast konkret të mbikëqyrjes që Kuvendi ka ndërmarrë mbi pushtetin ekzekutiv) A mendoni se Kuvendi ka përmbushur rolin e tij mbikëqyrës për të kontrolluar Qeverinë dhe institucionet në këtë rast?



# VI.

## FUNKSIONET E KUVENDIT






## VI. FUNKSIONET E KUVENDIT

Më shumë se gjysma (57%) e qytetarëve besojnë se deputetët ndikojnë mesatarisht ose ndikojnë shumë në cilësinë e ligjeve. Nga ana tjetër, përqindja e të anketuarve që mendojnë se deputetët kanë ndikim mesatar ose aspak nuk ndikojnë në cilësinë e ligjeve është 35%. Ky perceptim i qytetarëve, për sa i përket kontributit të deputetëve në përshtatjen dhe ndryshimin e zgjidhjeve normative të propozuara të paraqitura nga Qeveria, mbetet në një nivel relativisht konstant në krahasim me vitin e kaluar (Grafiku 16).

Grafiku 16. Sa ndikojnë deputetët në cilësinë e ligjeve në vendin tonë? (%)




Në shkallën nga 1 në 10 (ku 1 do të thotë aspak e rëndësishme, dhe 10 do të thotë shumë e rëndësishme), të anketuarit vlerësuan rëndësinë e funksioneve individuale të Kuvendit, sipas perceptimit të tyre. Nga të anketuarit u kërkua në shkallën nga 1 në 10, të përcaktojnë në cilën shkallë konsiderojnë se deputetët i plotësojnë ato funksione. Së këndejmi, si funksionet më të rëndësishme të Kuvendit, me notë 8.9, vlerësohen funksionet e miratimit të sa më shumë ligjeve cilësore në interes dhe sipas nevojave të qytetarëve, ushtrimit të kontrollit mbi Qeverinë dhe ministrinë dhe kujdesi për mënyrën e zbatimit të ligjeve dhe politikave (8.7). Megjithatë, edhe pse të anketuarit i konsiderojnë këto funksione si më të rëndësishmet, perceptimi i tyre është se deputetët i përmbushin me sukses të moderuar: funksioni i mbikëqyrjes ndaj Qeverisë dhe zbatimit të ligjeve ka marrë notën mesatare 4.7, ndërsa miratimi i ligjeve më cilësore ka marrë notën 5.

### 34 VËSHTRIM I KUVENDIT: PERCEPTIMI I QYTETARËVE PËR PUNËN E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Qytetarët e vlerësuan miratimin e sa më shumë ligjeve dhe ndryshimeve ligjore si funksionin më pak të rëndësishëm të Kuvendit, me notën mesatare 8,3. Të anketuarit mendojnë se edhe pse për mendimin e tyre kjo është më së paku e rëndësishme, krahasuar me funksionet e tjera të përmendura të Kuvendit, deputetët kanë bërë pikërisht atë - e cila vlerësohet me 5.6, përkatësisht notën më të lartë mesatare për sa i përket shkallës në të cilën Kuvendi përmbush funksionet themelore (Grafiku 17).

Grafiku 17. Nota mesatare në shkallën nga 1-10 për rëndësinë e funksioneve të Kuvendit dhe deri në çfarë mase deputetët i kryejnë ato



# VII.

## PUBLIKU NË PUNËN E KUVENDIT






## VII. PUBLIC IN THE WORK OF THE PARLIAMENT


Lidhur me hapjen e Kuvendit për publikun, gjysma e të anketuarve (57%) besojnë se Kuvendi është plotësisht ose pjesërisht i mbyllur për publikun, që paraqet rritje prej gjashtë pikë të përqindjes krahasuar me vitin 2025 (51%). Nga ana tjetër, më pak se një e treta (29%) e të anketuarve mendojnë se Kuvendi është plotësisht ose pjesërisht i hapur për pjesëmarrjen e publikut, çka përfaqëson një rënie prej 5 për qind krahasuar me vitin 2025. Në përgjithësi, rezultatet tregojnë për një perceptim më pak të favorshëm për hapjen e Kuvendit në krahasim me vitin e kaluar, ku te një pjesë më e madhe e qytetarëve mbizotëron përshtypja se institucioni ende nuk është mjaftueshëm i hapur ndaj publikut. (Grafiku 18).

Grafiku 18. Deri në çfarë mase mendoni se Kuvendi është i hapur për pjesëmarrjen e publikut në punën e tij? (%)




Të anketuarve iu lexuan emrat e deputetëve dhe deputeteve femra të zgjedhur/a nga njësia e tyre zgjedhore, pas së cilës u pyetën nëse e dinin se kush ishte përfaqësuesi i tyre i zgjedhur në Kuvend. Gjetjet tregojnë se edhe në vitin 2026, për shumicën e qytetarëve kjo informacion mbetet i pamjaftueshëm i njohur: 61% e të anketuarve janë përgjigjur se nuk e dinë kush është deputeti ose deputetja nga njësia e tyre zgjedhore, ndërsa 32% janë përgjigjur pozitivisht. Në krahasim me dy vitet e mëparshme, nuk vërehen ndryshime të rëndësishme, gjë që tregon një nivel relativisht të qëndrueshëm, por ende të ulët të njohjes së përfaqësuesve të zgjedhur nga qytetarët. Këto të dhëna tregojnë nevojën për një dukshmëri më të madhe dhe komunikim më aktiv të deputetëve me qytetarët në njësitë zgjedhore (Grafiku 19).

Grafiku 19. A e dini kush është deputeti/deputetja nga njësia juaj zgjedhore (%)




Gjetjet tregojnë se 87% e qytetarëve nuk kanë kontaktuar kurrë deputet për një çështje të caktuar. Nga të anketuarit, 13% thanë se kishin kontaktuar një deputet, nga të cilët 9% ishin të kënaqur me përgjigjen ose procedurën që ka ndërmarrë deputeti, ndërsa 4% nuk janë të kënaqur. Krahasuar me vitin 2025 dhe 2024, numri i përgjithshëm i qytetarëve të kontaktuar nga një deputet mbetet i pandryshuar (13%), duke treguar një nivel të ulët të vazhdueshëm të komunikimit të drejtpërdrejtë midis qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre të zgjedhur (Grafiku 20).

Grafiku 20. Have you ever contacted an MP from your constituency/municipality regarding a specific issue (face-to-face, via e-mail, social media, etc.)? (%)




Ndër të anketuarit që kanë deklaruar se kanë kontaktuar një deputet, mënyra më e përdorur e komunikimit është takimi në person, të cilin e kanë përmendur 47% prej tyre. Më pas vijnë rrjetet sociale me 23% dhe komunikimi përmes telefonit me 16%, ndërsa posta elektronike dhe takimet online janë dukshëm më pak të përdorura, me 7% dhe 5%, përkatësisht. Kanali më pak i përdorur është ueb platforma kancelarii.sobranie.mk, e cila u përmend vetëm nga 2% e të anketuarve. Këto gjetje tregojnë se komunikimi i drejtpërdrejtë, personal, vazhdon të ketë rëndësinë më të madhe në marrëdhënien midis qytetarëve dhe deputetëve, ndërsa kanalet digjitale dhe të institucionalizuara ende përdoren në një masë shumë më të vogël (Grafiku 21).

Grafiku 21. Si e keni kontaktuar deputetin? (%)




Perceptimi i të anketuarve për disponueshmërinë e deputetëve për takime me qytetarët mbetet relativisht i ulët edhe në vitin 2026. Gjegjësisht, 21% e të anketuarve besojnë se deputeti ose deputetja nga rajoni i tyre është në dispozicion për takime, që paraqet një rënie të lehtë në krahasim me vitin 2025, kur ishte 25%. Në të njëjtën kohë, 35% besojnë se deputetët nuk janë të disponueshëm, që është pothuajse në të njëjtin nivel me vitin e kaluar. Pjesën më të madhe, megjithatë, e përbëjnë qytetarët që nuk e dinë ose nuk kanë një qëndrim të formuar për këtë çështje, ndërsa përqindja e tyre në vitin 2026 është 44%. Këto gjetje sugjerojnë se, përveç disponueshmërisë relativisht të kufizuar të deputetëve, një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve ende nuk kanë informacion të mjaftueshëm ose përvojë të drejtpërdrejtë që të mund të vlerësojnë gatishmërinë e tyre për takime (Grafiku 22).

Grafiku 22. Deputeti/deputetja nga rajoni juaj (komuna, njësia zgjedhore) është në dispozicion për takime me qytetarë? (%)




Në vitin 2026, 73% e të anketuarve deklaruan se nuk ishin të njohur me zyrat e deputetëve, që është pothuajse në të njëjtin nivel me vitin 2025. Në të njëjtën kohë, 20% janë përgjigjur se ishin të njohur me zyrën, por nuk e kishin vizituar, ndërsa vetëm 5% thanë se e kishin vizituar. Në krahasim me vitet e mëparshme, nuk vërehen ndryshime të mëdha, gjë që tregon dukshmëri të kufizuar dhe përdorim të ulët të këtij mekanizmi për kontakt midis qytetarëve dhe deputetëve. Megjithatë, fakti që rreth një e katërta e qytetarëve janë të paktën të njohur ose kanë pasur kontakte të drejtpërdrejta përmes zyrave tregon se ekziston një bazë për forcimin e mëtejshëm të tyre dhe promovim më të madh në nivel lokal (Grafiku 24).

Grafiku 23. A jeni të njohur me zyrat parlamentare në rajonin/komunën tuaj dhe a i keni vizituar deri më tani zyrat e deputetëve? (%)




Më shumë se gjysma e të anketuarve që deklaruan në pyetjen e mëparshme se kanë vizituar zyrën parlamentare deklaruan se e kanë bërë këtë për të shtruar një pyetje deputeti (53%), ndërsa afërsisht një e treta (31%) e kanë vizituar zyrën për të iniciuar një iniciativë civile, ndërsa 5% thanë se e kanë bërë këtë për «nevoja personale» (Grafiku 25). Këto gjetje paraqesin një ndryshim të rëndësishëm nga viti i kaluar, me një rritje të dukshme të interesit për të shtruar pyetje deputeti, ndërsa inicimi i iniciativave qytetare pozicionohet si një arsye dytësore për vizita. Kjo prirje mund të nënkuptojë që qytetarët gjithnjë e më shumë po përdorin zyrën e deputetëve si një mekanizëm për të kërkuar përgjigje dhe llogaridhënie nga deputetët për çështje specifike ose ngjarje aktuale, sesa si një hapësirë për të propozuar iniciativa në mënyrë proaktive. Në të njëjtën kohë, kjo prirje mund të tregojë ulje të besimit ose ndërgjegjësimit për efektivitetin e iniciativave qytetare.

Grafiku 24. (Nga qytetarët që deklaruan se kishin vizituar zyrën lokale për kontakt të deputetëve me qytetarët) Cili ishte qëllimi i vizitës suaj? (%)




Te qytetarët që kanë deklaruar se kanë vizituar zyrën lokale për kontakt me deputetët, edhe në vitin 2026 mbizotëron një perceptim pozitiv për përgjigjen e marrë. Shumica e tyre, 58%, thanë se ishin shumë të kënaqur, që është përqindja më e lartë krahasuar me dy vitet e mëparshme. 40% të tjerë thanë se ishin pjesërisht të kënaqur, ndërsa vetëm 2% shprehën pakënaqësi. Këto rezultate tregojnë se, megjithëse vizitat në këto zyra mbeten të ulëta, përvoja e qytetarëve që i kanë përdorur ato është kryesisht pozitive dhe në vitin 2026 shënon një përmirësim të mëtejshëm (Grafiku 25).

Grafiku 25. (Nga qytetarët që thanë se kishin vizituar zyrën lokale për kontakt të deputetëve me qytetarët) Sa jeni të kënaqur me përgjigjen që keni marrë nga vizita juaj? (%)




Kur u pyetën se si mendojnë se deputetët duhet të informojnë qytetarët për punën e tyre, mbi dy të tretat e të anketuarve (66%) besojnë se kjo duhet të bëhet përmes takimeve me qytetarë në vende publike, ndërsa pothuajse gjysma (54%) besojnë se duhet të informohen përmes paraqitjeve publike. Mediat, si kanali optimal i raportimit, përmenden nga 53% e qytetarëve, ndërsa 44% përmenden rrjetet sociale (Grafiku 26). Preferenca për takime në zyrat e deputetëve është ulur në 32%, që është përqindja më e ulët në 3 vitet e fundit. Këto gjetje tregojnë se qytetarët kanë një nevojë në rritje për komunikim më të drejtpërdrejtë, më të dukshëm dhe më proaktiv nga ana e deputetëve, përtej hapësirave formale institucionale. Mbështetja e lartë për takimet në vende publike sugjeron që pritet disponueshmëri dhe prani më e madhe «në terren», ku komunikimi është më i arritshëm dhe më pak formal.

**Grafiku 26.** Në çfarë mënyre mendoni se deputetët tuaj duhet t'i informojnë qytetarët për punën e tyre? (%)




Në vitin 2022, Kuvendi vendosi edhe një mënyrë tjetër të kontaktit dhe përfshirjes së qytetarëve përmes aktivitetit Karvani Parlamentar. Me Karvanin Parlamentar, deputetët rajonalë ose lokalë, së bashku me një pjesë të Shërbimit Parlamentar, organizojnë ngjarje në qytete të ndryshme, ku qytetarët mund të takohen drejtpërdrejt me deputetët. Qytetarët u pyetën nëse ishin njohur me këtë aktivitet dhe nëse kishin marrë pjesë në të. Gjetjet tregojnë se edhe në vitin 2026 shumica e të anketuarve, përkatësisht 71%, nuk janë të njohur me Karvanin Parlamentar. Nga ana tjetër, 19% thanë se ishin të njohur me këtë nismë, por nuk kanë marrë pjesë, ndërsa 10% thanë se ishin të njohur dhe kanë marrë pjesë në aktivitet. Në krahasim me vitin 2025, ka një rritje të lehtë si në informimin ashtu edhe në pjesëmarrje, gjë që tregon një përmirësim të lehtë të dukshmërisë së kësaj iniciative (Grafiku 27).

Grafiku 27. A jeni njohur me aktivitetin Karvani Parlamentar, si një mënyrë për të kontaktuar dhe përfshirë qytetarët në punën e Kuvendit? (%)



Perceptimi i përgjithshëm i qytetarëve është se deputetët nuk u kushtojnë vëmendje të mjaftueshme problemeve të komunave dhe bashkësive lokale. Pothuajse gjysma e të anketuarve (38%) janë përgjigjur se perceptimi i tyre është se nuk ka ndodhur që një deputet i rajonit të tyre të ketë iniciuar iniciativë në Kuvend për një problem lokal, ndërsa 19% e të anketuarve kanë deklaruar se deputeti i tyre e ka bërë këtë. Këto rezultate vërejnë një nivel të ngjashëm të perceptimit midis qytetarëve në krahasim me vitin 2025, dhe një rritje të lehtë të përqindjes së qytetarëve që janë neutralë, përkatësisht, nuk kanë formuar mendim në lidhje me deputetin e tyre dhe procesin e inicimit të një problemi lokal në krahasim me tre vitet e kaluara (Grafiku 28).


Grafiku 28. Has it ever happened that an MP from your region raised an initiative in the Parliament about an issue faced by your municipality? (%)



#### 44 VËSHTRIM I KUVENDIT: PERCEPTIMI I QYTETARËVE PËR PUNËN E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT


Qytetarët u pyetën gjithashtu nëse ka ndodhur që ndonjë deputet apo deputete të ketë ndërmarrë një iniciativë në Kuvend, ose në paraqitjet e tij/saj publike të ketë përfaqësuar një çështje që është në interes të tyre. Edhe në këtë pyetje mbizotëron perceptimi negativ: 51% e të anketuarve në vitin 2026 u përgjigjën se nuk ka ndodhur një gjë e tillë, ndërsa 17% thanë se ka ndodhur. Në krahasim me vitin 2025, përqindja e përgjigjeve pohuese është ulur lehtë, nga 19% në 17%, ndërsa përqindja e përgjigjeve negative është rritur nga 43% në 51%. Në të njëjtën kohë, 31% e të anketuarve u përgjigjën se nuk dinin ose nuk kishin qëndrim për këtë pyetje. Këto rezultate sugjerojnë se në mesin e shumicës së qytetarëve ende nuk ka perceptim se deputetët në mënyrë aktive ndërmarrin iniciativa ose përfaqësojnë çështje në interesin e tyre (Grafiku 29).

Grafiku 29. Has it ever happened that an MP initiated an initiative in the Parliament on an issue in your interest or advocated an issue of your interest in his/her public appearances? (%)




Mbi dy të tretat e qytetarëve deklaruan se nuk janë të interesuar për punën e Kuvendit (71%), ndërsa edhe më e lartë është përqindja e qytetarëve që nuk duan të angazhohen në aktivitetet e tij (89%). Të qenit i informuar për punën e Kuvendit është një qëllim më pasiv dhe i arritshëm në krahasim me përfshirjen në punën e tij, gjë që në një farë mase shpjegon dallimin në përqindjet të të dy pyetjeve (Grafiku 30).

Grafiku 30. Are you interested in being informed and getting involved in the work of the Parliament? (%)



Të anketuarve iu lexuan disa mekanizma se si mund të marrin pjesë në punën e Kuvendit. Nga opsionet e ofruara, përqindja më e madhe e të anketuarve ishin të informuar se mund t'u bënin pyetje deputetëve (20%) ose të kërkonin takim me deputet (20%). Megjithatë, shumica e të anketuarve (61%), nuk ishin të njohur me asnjë nga mekanizmat e lexuar dhe në dispozicion për pjesëmarrje në punimet e Kuvendit. Krahasuar me vitin e kaluar, tendenca e mënyrave të zgjedhura të pjesëmarrjes është përgjithësisht e njëjtë, por përqindja e qytetarëve që u përgjigjën se nuk janë të njohur është përkeqësuar, pra është rritur me pesë pikë të përqindjes (Grafiku 31).

Grafiku 31. In what way do you think you can participate in the work of the Parliament? (%)





# VIII.

**KË PËRFAQËSOJNË  
DEPUTETËT NË KUVEND**






## VIII. KË PËRFAQËSOJNË DEPUTETËT NË KUVEND


Gjithsej 74% e qytetarëve të anketuar besojnë se deputetët në Kuvend gjithmonë përfaqësojnë interesat e tyre personale, ndërsa 66% sugjeruan interesin e rrethit më të ngushtë të udhëheqjes së partisë. Më shumë se gjysma (56%) e të anketuarve zgjedhën komunitetin e biznesit si më të përfaqësuarin nga deputetët, ndërsa perceptimi i vetëm 9% të të anketuarve është se deputetët përfaqësojnë interesat e të gjithë qytetarëve, një rritje prej 3% krahasuar me vitin e kaluar. Përgjigjet e tilla tregojnë një perceptim midis qytetarëve se avokimi i interesit publik nga deputetët është relativisht i marginalizuar në kurriz të interesave të tjera prioritare (Grafiku 32).

Grafiku 32. Sa shpesh përfaqësojnë deputetët interesat si më poshtë? (%)




Të anketuarit u pyetën se cilat grupe të marginalizuara, sipas tyre, përfaqësohen më mirë në Kuvend. Kështu, përqindja më e lartë e qytetarëve përmendën personat me aftësi të kufizuara (18%), pasuar nga përfituesit e ndihmës sociale (17%), personat e moshuar (16%) dhe romët (15%). Më pak se 10% e qytetarëve besojnë se të papunët (9%), prindërit e vetëm (9%), banorët nga rajonet rurale (6%) dhe gratë (5%) janë përfaqësuar në mënyrë përkatëse. Megjithatë, mungesa e një qëndrimi sërish mbizotëron si përgjigje, përkatësisht 37% nuk janë përgjigjur ose janë deklaruar se nuk e dinë, gjë që paraqet një rritje prej 4% krahasuar me vitin e kaluar. (Grafiku 33).

Grafiku 33. Cilat nga grupet e mëposhtme të qytetarëve, mendoni se përfaqësohen më së miri nga Kuvendi? (%)



Perceptimet e qytetarëve për atë se sa në mënyrë efektive Kuvendi i merr parasysh nevojat dhe interesat e sektorit privat janë kryesisht të përqendruara rreth mesit të shkallës. Pothuajse gjysma e të anketuarve (48%) dhanë notën 3, që sugjeron notë mesatare, përkatësisht një perceptim se ky rol është përmbushur pjesërisht, por pa kënaqësi më të theksuar. Nota më të larta kanë dhënë 25% e qytetarëve, prej të cilëve 18% kanë dhënë notën 4 ndërsa 7% notën 5, ndërsa 27% kanë dhënë nota më të ulëta, përkatësisht 9% notën 1 dhe 18% notën 2. Këto gjetje tregojnë se te qytetarët nuk mbizotëron një perceptim qartësisht negativ, por as një perceptim dukshëm pozitiv; përkundrazi, mbizotëron një qëndrim i përmbajtur lidhur me atë se sa Kuvendi i njeh dhe i integron interesat e sektorit privat në punën e tij. (Grafiku 34)

Grafiku 34. Në shkallën nga 1 deri në 5, sa efektivisht mendoni se Kuvendi merr parasysh nevojat dhe interesat e sektorit privat (bizneseve dhe kompanive)? (%)





**IX.**

**DEBATI PARLAMENTAR**






## IX. DEBATI PARLAMENTAR

Perceptimi i pothuajse dy të tretave të qytetarëve të anketuar (67%) është se në debatet parlamentare shumica parlamentare kryesisht ose aspak nuk merr parasysh argumentet e opozitës gjatë marrjes së vendime, që paraqet rritje prej 7% në krahasim me vitin e kaluar. Për 19% të të anketuarve, shumica kryesisht i merr parasysh, ndërsa 7% u përgjigjën se në diskutimet pushteti merr parasysh plotësisht argumentet e opozitës, që është një përmirësim prej 1% nga viti i kaluar (Grafiku 35).


Grafiku 35. Deputetët e shumicës parlamentare marrin parasysh argumentet e deputetëve të opozitës gjatë vendimmarrjes në Kuvend (%)



Perceptimi se sa opozita merr parasysh argumentet e deputetëve të shumicës në pushtet është i ngjashëm. Gjithsej 71% e të anketuarve vlerësojnë se opozita kryesisht ose aspak nuk i merr parasysh këto argumente, ndërsa 19% vlerësojnë se kryesisht ose plotësisht i merr parasysh ato. Krahasuar me vitin e kaluar, ka një perceptim të përqësuar të bashkëpunimit midis grupeve parlamentare (Grafiku 36).


Këto gjetje tregojnë një perceptim dominues të konfrontimit sesa të bashkëpunimit midis deputetëve nga qeveria dhe opozita, gjë që minon pritshmërinë e një dialogu konstruktiv parlamentar. Përqindjet e ulëta të përgjigjeve pozitive tregojnë se qytetarët vazhdojnë të kenë besim të kufizuar në komunikimin ndërpartiak si bazë për vendimmarrje cilësore.

Grafiku 36. The MPs from the opposition take into account the arguments of the MPs from the majority when making decisions in the Parliament. (%)




Shumica e qytetarëve (55%) mendojnë se ekziston dëshirë midis partive për kompromis në interes të qytetarëve, megjithatë kjo ndodh rrallë. Vetëm 7% u përgjigjën se partitë vijnë shpesh në një kompromis të tillë, ndërsa 38% u përgjigjën se kurrë nuk ndodh kështu. Sa i përket përkatësisë etnike, pesimizmi më i theksuar u vërejt në mesin e maqedonasve etnikë, 41% e të cilëve u përgjigjën se partitë kurrë nuk kanë sens për kompromis. Në të kundërt, shqiptarët etnikë kanë pjesën më të ulët të të anketuarve me këtë qëndrim, përkatësisht 25%, gjë që tregon një perceptim më të moderuar në lidhje me mundësinë e kompromisit ndërpartiak (Grafiku 37).

Grafiku 37. A mendoni se partitë janë të gatshme të bëjnë kompromis me njëra-tjetrën, për të gjetur një zgjidhje të përbashkët që është në interes të publikut, përkatësisht në interes të qytetarëve? (%)



Më shumë se dy të tretat e qytetarëve të anketuar (64%) kanë përshtypje se deputetët në seanca shpesh ose gjithmonë përdorin fjalë që përçmojnë dhe degradojnë kundërshtarët e tyre politikë në bazë të përkatësisë së tyre politike, etnike, fetare dhe gjinore. Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, 49% besojnë se deputetët këtë e bëjnë shpesh, ndërsa 15% vlerësojnë se gjuha e tillë përdoret gjithmonë. Nga ana tjetër, 26% e qytetarëve thonë se deputetët rrallë ose kurrë nuk përdorin gjuhë të tillë. Në krahasim me vitin 2025, ka një rritje të lehtë të pjesës së të anketuarve që besojnë se deputetët përdorin gjithmonë fjalor nënçmues dhe degradues, por perceptimi i përgjithshëm për këtë çështje mbetet pothuajse i pandryshuar. Pavarësisht luhatjeve të caktuara ndër vite, midis qytetarëve mbizotëron vazhdimisht përshtypja se në debatet parlamentare shpesh përdoret fjalor që nënçmon kundërshtarët politikë (Grafiku 38).

Grafiku 38. Sipas mendimit tuaj, sa shpesh deputetët përdorin gjuhën e urrejtjes ose gjuhën diskriminuese në fjalimet e tyre? (%)







**REFORMA**






## X. REFORMA


Pothuajse gjysma e të anketuarve (57%) mendojnë se është e rëndësishme të formohen grupe shumë-partiake në Kuvend në të cilat deputetë nga parti të ndryshme do të bashkohen rreth të njëjtave çështje, që paraqet rritje prej 8% krahasuar me vitin 2025. Nga ana tjetër, 24% e të anketuarve nuk pajtohen me këtë. Duke pasur parasysh rezultatet në lidhje me këtë pyetje nga vitet e kaluara, ka një rritje të lehtë të mbështetjes së qytetarëve për grupet shumë-partiake, ndryshe nga vitet e kaluara kur rezultatet treguan një rënie të vazhdueshme (Grafiku 39).

Grafiku 39. A mendoni se është e rëndësishme të formohen grupe shumë-partiake në Kuvend (p.sh. si Klubi i deputeteve) në të cilët, deputetë nga parti të ndryshme do të bashkohen rreth të njëjtave çështje? (%)



Qytetarët të cilët thanë se ishte e rëndësishme të formoheshin grupe shumë-partiake në Kuvend u pyetën gjithashtu se cilat çështje ishin të rëndësishme për të formuar grupe të tilla. Kështu, 58% e të anketuarve mendojnë se grupe të tilla duhet të formohen për çështje që lidhen me të rinjtë, ndërsa 57% mendojnë se ato duhet të formohen për çështje rreth dukurisë së korrupsionit në vend. Çështjet e personave të papunë dhe personave me aftësi të kufizuara përmenden nga 56% e të anketuarve, ndërsa 54% besojnë se grupe të tilla duhet të formohen për nevojat e prindërve të vetëm. Një përqindje e lartë e të anketuarve sugjeruan nevojën për mbrojtjen e mjedisit (47%), gjë që nuk ishte rast në vitet e mëparshme. Më poshtë në listë për sa i përket përqindjeve, me më pak se një e katërta e të anketuarve janë përmendur romët (22%) dhe vetëm komuniteti LGBTQ+ (3%) dhe viktimat e dhunës (0.4%). (Grafiku 40).

Grafiku 40. Për cilat çështje mendoni se është e rëndësishme të formohen grupe të tilla? (%)



# XI.

## NOTA MESATARE PËR PUNËN E KUVENDIT






## XI. NOTA MESATARE PËR PUNËN E KUVENDIT

Të anketuarit në shkallën nga 1 deri në 5, ku 1 është më keq dhe 5 më mirë, vlerësuan punën e Kuvendit me notë mesatare prej 2.7. Krahasuar me vitin 2025, puna e Kuvendit u vlerësua me notë mesatare prej 2.5, mund të vërehet një rritje prej 0.2 pikë. Vlerësimi për punën e Kuvendit është luhatur ndër vite, ku 3 vitet e fundit ka pasur rritje të vazhdueshme. Notën mesatare më të lartë në 15 vitet e fundit, prej 3.4, Kuvendi e mori në vitin 2017 (Grafiku 44). Megjithëse nota e përgjithshme për punën e Kuvendit mbetet relativisht e ulët, ka pasur një përmirësim gradual në lidhje me perceptimin në tre vitet e fundit, duke treguar një tendencë të vogël, por të qëndrueshme drejt rritjes së kënaqësisë së qytetarëve. Kjo prirje është inkurajuese, por vazhdon të tregojë se Kuvendi ka hapësirë të konsiderueshme për të promovuar punën dhe llogaridhënien e tij ndaj publikut.

Grafiku 41. Nota mesatare për punën e Kuvendit (në shkallën 1 - më e ulëta deri në 5 - më mirë)





# XII.

## KONTEKSTI POLITIK DHE BESIMI NË INSTITUCIONET






## XII. KONTEKSTI POLITIK DHE BESIMI NË INSTITUCIONET

Të anketuarit u pyetën në cilin drejtim mendojnë se po ecën jeta në Maqedoninë e Veriut. Pothuajse gjysma e të anketuarve (51%) mendojnë se jeta në vend po ecën në drejtimin e gabuar, ndërsa më shumë se një e katërta e të anketuarve (28%) mendojnë se jeta po ecën në drejtimin e duhur. Në krahasim me vitin 2025, ka një ndryshim marginal në perceptimin e qytetarëve për këtë temë, përkatësisht 1% më shumë se vitin e kaluar besojnë se vendi po lëviz në drejtimin e duhur, ndërsa 3% më pak besojnë se po lëviz në drejtimin e gabuar. Perceptimi i këtij viti ka ngjashmërinë më të madhe me perceptimin e vitit të kaluar (Grafiku 45). Këto rezultate tregojnë një zhvendosje të lehtë optimiste në perceptimin e publikut për drejtimin e zhvillimit shoqëror, por në të njëjtën kohë konfirmojnë se pakënaqësia dhe ndjenjat e pasigurisë mbeten dominuese në mesin e shumicës së qytetarëve.

Grafiku 42. A mendoni se jeta në përgjithësi në Maqedoninë e Veriore po lëviz në: (%)




Sa i përket besimit të qytetarëve në institucionet publike, në vitin 2026 nuk ka pasur ndryshime të mëdha në krahasim me vitin paraprak, por kryesisht stabilitet me zhvendosje të vogla në institucione të caktuara. Komunitetet fetare dhe ushtria vazhdojnë të jenë institucionet në të cilat qytetarët kanë besimin më të lartë, megjithëse të dyja shënojnë një rënie të lehtë në krahasim me vitin 2025, përkatësisht nga 6.3 në 5.9 në komunitetet fetare dhe nga 6.1 në 6.0 në ushtri. Më pas vijnë mediat dhe policia, me një notë mesatare prej 5.3, ku besimi te mediat shënon një rritje të lehtë, ndërsa te policia mbetet i pandryshuar.

## 70 VËSHTRIM I KUVENDIT: PERCEPTIMI I QYTETARËVE PËR PUNËN E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Besimi në Kuvend në vitin 2026 ishte 4.8, që është një përmirësim i lehtë në krahasim me 4.6 në vitin 2025. Në të njëjtën kohë, besimi tek Qeveria dhe Presidenti mbetet i pandryshuar, me një rezultat mesatar 4.7 dhe 4.9. Rritje të lehtë shënojnë edhe administrata publike, nga 4.6 në 4.9, institucionet shëndetësore, nga 4.4 në 5.0, si dhe organizatat joqeveritare, nga 4.6 në 5.0. Rritja, megjithëse e moderuar, ekziston edhe në gjyqësor dhe prokurori publike, të cilat në vitin 2026 u vlerësuan me 3.5 dhe 3.6.


Nga ana tjetër, besimi në pushtetin lokal shënon një rënie të lehtë, nga 5.1 në 5.0, ndërsa besimi në partitë politike mbetet i pandryshuar, me notë 4.0. Në përgjithësi, gjetjet tregojnë një shpërndarje relativisht të qëndrueshme të besimit, ku niveli më i lartë i besimit vazhdon të jetë ndaj institucioneve që nuk janë drejtpërdrejt të lidhura me arenën e politikës ditore, ndërsa institucionet e sistemit gjyqësor mbeten ndër më të vlerësuarat më ulët, megjithëse edhe te ato vërehet një përmirësim i lehtë (Grafiku 43).

Grafiku 43. Në shkallën nga 1 – më e ulëta deri në 10 – më e larta, vlerësoni besimin Tuaj te institucionet e mëposhtme (%)




Të njëjtit grup qytetarësh, përkatësisht ata që besimin në Kuvend e kanë vlerësuar me notë 4 ose më të ulët në shkallën nga 1 deri në 10, u pyetën gjithashtu se çfarë duhet të përmirësojnë deputetët në punën e tyre për të rritur besimin në Kuvend. Më së shpeshti, ata theksojnë se deputetët duhet të punojnë në interes të qytetarëve dhe të shtetit (37%), si dhe të jenë të ndershëm, të përgjegjshëm, parimorë dhe profesionalë (27%). Më pas vijnë kërkesat për miratimin e ligjeve më cilësore në interes të qytetarëve (12%), transparencë dhe llogaridhënie më të madhe ndaj publikut (11%) dhe një luftë më të vendosur kundër korrupsionit dhe kriminalitetit (11%). Këto përgjigje tregojnë se besimi i ulët në Kuvend është i lidhur ngushtë me pritshmëritë për llogaridhënie më të madhe, integritet, transparencë dhe orientim më të qartë drejt interesit publik në punën e deputetëve (Grafiku 44).

Chart 44. (Qytetarët që e vlerësuan besimin në Kuvend me notën 4 ose më të ulët, në shkallën prej 1 – më e ulët deri në 10 – më e lartë) Sipas mendimit Tuaj, cilat janë arsyet kryesore pse keni besim më të ulët në punën e Kuvendit? (përmenden më shpesh) (%)




Qytetarët që vlerësuan besimin e tyre në Kuvend me notë mesatare prej 4 ose më të ulët, në shkallën prej 1 – më të ulët deri në 10 – më të lartë, u pyetën për arsyet kryesore pse ata kanë këtë shkallë relativisht të ulët të besimit në Kuvend. Arsyet më të përmendura janë perceptimi se deputetët nuk punojnë me ndërgjegje dhe profesionalizëm, gjë që është theksuar nga 29% e të anketuarve, si dhe qëndrimi se nuk punojnë në interes të qytetarëve dhe të shtetit, i përmendur nga 27%. Pastaj është korrupsioni, me 19%, dhe miratimi i ligjeve të këqija, domethënë ligje që perceptohen se janë si pasojë e interesave personale, me 15%. Një numër më i vogël i të anketuarve gjithashtu sugjerojnë për mos përmbushjen e premtimeve, politikat e gabuara, partizimin, si dhe mungesën e përgjegjësisë. Këto përgjigje tregojnë se besimi i ulët në Kuvend lidhet kryesisht me perceptimet për profesionalizëm të pamjaftueshëm, mungesë interesi publik për vendimmarrje dhe probleme më të gjera që lidhen me integritetin dhe cilësinë e punës legjislative.

Grafiku 45. (Qytetarët që vlerësuan besimin në Kuvend me notë 4 ose më të ulët, në shkallën prej 1 – më e ulët deri në 10 – më e lartë) Çfarë duhet të përmirësojnë deputetët në punën e tyre në mënyrë që Ju të rrisni besimin tuaj në Kuvend? % (përmenden më shpesh) (%)




Të anketuarit u pyetën se si ndryshoi pozicioni i partive opozitare në Kuvend, pra nëse ai u forcua apo u dobësua. Pothuajse gjysma e të anketuarve (44%) u përgjigjën se mbeti pothuajse i njëjtë, ndërsa 45% u përgjigjën se ishte dobësuar pjesërisht ose plotësisht. Vetëm 11% besojnë se opozita është forcuar plotësisht ose pjesërisht. Ky konstatim tregon se qytetarët kryesisht i perceptojnë grupet parlamentare të opozitës si të dobëta, me fuqi të pamjaftueshme për të vepruar. (Grafiku 46)

Grafiku 46. Në krahasim me periudhën e një viti më parë, si mendoni se ka ndryshuar pozicioni i partive opozitare në Kuvend? (%)



Në pyetjen se kush do të luajë rol kryesor në përcaktimin e agjendës legjislative në Kuvend vitin e ardhshëm, 44% e të anketuarve përmendin koalicionin qeverisës si potencialisht aktorin më me ndikim. Pothuajse një e katërta (21%) besojnë se aktorët e jashtëm, si BE dhe Shtetet e Bashkuara, do të kishin një ndikim të rëndësishëm, ndërsa 17% përmendën pushtetin ekzekutiv. Një pjesë më e vogël e të anketuarve (12%) besojnë se deputetët të caktuar luajnë rol kryesor dhe vetëm 7% e njohin opozitën si faktorin më me ndikim në formësimin e agjendës legjislative. (Grafiku 47)


Chart 47. Looking ahead to the next 12 months, who do you think will play the key role in setting the legislative agenda in the Parliament? (%)



Këto gjetje tregojnë një perceptim të një përqendrimi të lartë të pushtetit midis strukturave qeverisëse, ku procesi legjislativ perceptohet si i dominuar nga shumica dhe i lidhur ngushtë me pushtetin ekzekutiv. Në të njëjtën kohë, njohja relativisht e lartë e rolit të aktorëve të jashtëm sugjeron që disa qytetarë e perceptojnë agjendën legjislative si nën ndikim të rëndësishëm ndërkombëtar, veçanërisht në kontekstin e integritimeve evropiane. Përqindja e ulët për opozitën dhe deputetët të caktuar, mund të sugjerojë besim të kufizuar në aftësinë e tyre për të ndikuar në mënyrë efektive në procesin legjislativ, gjë që ngre pyetje në lidhje me perceptimin e pluralizmit dhe ekuilibrit në funksionimin e Kuvendit.

Në pyetjen se cila është natyra e mbështetjes që Kuvendi ofron në procesin e zhbllokimit të integritimeve evropiane, mendimet e të anketuarve janë të ndara. Shumica e tyre, 31%, besojnë se Kuvendi nuk ofron mbështetje të konsiderueshme në këtë proces, ndërsa 21% thanë se nuk dinë ose nuk kanë informacion të mjaftueshëm. Ndër ata që njohin një rol më specifik të Kuvendit, 28% besojnë se ai realizohet më së shumti përmes aktiviteteve legjislativë, 27% përmes diplomacisë parlamentare dhe 22% përmes mbikëqyrjes parlamentare të Qeverisë (Grafiku 48).


Grafiku 48. Kuvendi mbështet procesin e zhbllokimit të procesit të integritimit evropian: (%)



Këto gjetje tregojnë një nivel të ulët të perceptimit të qartë dhe të qëndrueshëm për rolin e Kuvendit në integrimin evropian. Përqindja e lartë e të anketuarve që mendojnë se nuk ka mbështetje të konsiderueshme, së bashku me ata që nuk kanë informacion të mjaftueshëm, mund të tregojë për një mungesë të dukshme të komunikimit të aktiviteteve parlamentare të lidhura me këtë proces. Në të njëjtën kohë, shpërndarja e përgjigjeve midis të anketuarve të tjerë sugjeron se nuk ka narrativë mbizotëruese për mekanizmat përmes të cilave kontribuon Kuvendi, që mund të nënkuptojë se roli i tij perceptohet si i fragmentuar ose i artikuluar në mënyrë të pamjaftueshme në diskursin publik.


Në lidhje me çështjet e sigurisë kombëtare, të anketuarit u pyetën këtë vit për herë të parë për shkallën e harmonizimit midis deputetëve. Rezultatet tregojnë se pjesa më e madhe e qytetarëve, 40%, vlerësojnë se ekziston një harmonizim i moderuar, ndërsa 45% vlerësojnë se deputetët janë pak ose aspak të harmonizuar në raport me prioritetet kyçe të sigurisë kombëtare. Vetëm 15% e të anketuarve mendojnë se deputetët në masë të madhe ose plotësisht janë në përputhje me këto çështje (Grafiku 49).

Figure 49. Deri në çfarë mase deputetët janë të harmonizuar me prioritetet kryesore të sigurisë kombëtare? (%)



Në pyetjen se si e vlerësojnë aftësinë e Kuvendit për t'u përgjigjur ndaj sfidave që lidhen me sigurinë kombëtare, pjesa më e madhe e të anketuarve, 39%, kanë dhënë një notë mesatare, përkatësisht e kanë vlerësuar si të kënaqshme. Megjithatë, 48% e qytetarëve besojnë se aftësia e Kuvendit është e dobët ose shumë e dobët, ndërsa vetëm 14% e vlerësuan atë si të fortë ose shumë të fortë (Grafiku 50).

Grafiku 50. Si e vlerësoni aftësinë e Kuvendit për t'iu përgjigjur sfidave të sigurisë kombëtare? (%)



Këto gjetje tregojnë për një perceptim kryesisht të përmbajtur, por më kritik se sa pozitiv të gatishmërisë së Kuvendit për t'iu përgjigjur çështjeve të sigurisë kombëtare. Edhe pse të një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve mbizotëron qëndrimi se ekziston të paktën një nivel i caktuar harmonizimi ndërmjet deputetëve, përqindja më e lartë e të anketuarve që shohin harmonizim të dobët dhe kapacitete të kufizuara institucionale sugjeron një rezervë në lidhje me efektivitetin e përgjigjes parlamentare në kushte sfidash të sigurisë.

## XIII. SHPËRNDARJA DEMOGRAFIKE E TË ANKETUARVE

		Апсолутен број	Процент
Gjinia	Meshkuj	494	49.3%
	Femër	508	50.7%
	Tjetër	0	0%
Totali		1002	100.0%

Mosha	Nën 18 vjeç	0	0.0%
	18-29	209	20.9%
	30-39	190	19.0%
	40-49	214	21.4%
	50-59	161	16.1%
	60+	228	22.8%

Vendbanimi	Urban	580	57.9%
	Rurale	422	42.1%

Rajoni	Rajoni i Vardarit	76	7.6%
	Rajoni Lindor	88	8.8%
	Rajoni Jugperëndimor	103	10.3%
	Rajoni Juglindor	88	8.8%
	Rajoni i Pellagonisë	124	12.4%
	Rajoni i Pollogut	140	14.0%
	Rajoni Verilindor	83	8.3%
	Rajoni i Shkupit	300	29.9%

Përkatësia etnike	Maqedonas	657	65.6%
	Shqiptar	254	25.3%
	Tjetër	91	9.1%

Statusi ekonomik	I/e punësuar zyrtarisht në sektorin publik me orar të plotë	215	21.5%
	I/e punësuar zyrtarisht në sektorin shtetëror me orar të shkurtuar	12	1.2%
	I/e punësuar zyrtarisht në sektorin privat me orar të plotë	302	30.1%
	I/e punësuar zyrtarisht në sektorin privat me më pak se 30 orë	18	1.8%
	I/e vetëpunësuar (punon në kompani personale ose dyqan)	36	3.6%
	Angazhim joformal që sjell të ardhura të rregullta	18	1.8%
	Angazhim joformal që sjell të ardhura herë pas here	27	2.7%
	Student/e	88	8.8%
	Pensionist/e	175	17.5%
	Person me aftësi të kufizuara që nuk mund të punojë	9	0.9%
	Nuk ka punë dhe nuk e ka kërkuar në 30 ditët e fundit	43	4.3%
	Nuk ka punë dhe ndjek aktivisht shpalljet për punë dhe kërkon punë	45	4.5%
	Nuk dëshiron të përgjigjet	14	1.4%

# INFORMACIONE RRETH PROJEKTIT

Programi Zviceran për Mbështetje Parlamentare (PMP) mbështet përpjekjet e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për pavarësi përmes ndërtimit të konsensusit, reforma strukturore dhe ndërtimin e kapaciteteve; në rolet e tij ligjvënëse dhe mbikëqyrëse; dhe në transparencën dhe llogaridhënien e tij institucional.

Programi ofron mbështetje për planifikimin strategjik të Kuvendit; për reformat në menaxhimin e burimeve njerëzore; për përmirësimin e vlerësimit të ndikimit rregullator dhe proceseve të prokurimit; për përpjekjet për hapje më të madhe dhe të dhëna më të hapura dhe për angazhim më të madh qytetar në proceset e krijimit të politikave. Gjithashtu ofron mbështetje përmes matjes së opinionit publik dhe monitorimit të përpjekjeve për reforma, duke përfshirë këtë hulumtim të opinionit publik.

Program për Mbështetje Parlamentare mbështetet nga Qeveria e Zvicrës dhe zbatohet nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup (IDSCS) dhe Qendra për Menaxhim me Ndryshime (QMN).

# INFORMACION RRETH INSTITUTIT PËR DEMOKRACI

Instituti për Demokraci është tink tenk organizatë, që hulumton zhvillimin e qeverisjes së mirë, sundimin e së drejtës dhe integrimet evropiane të Maqedonisë. IDSCS ka mision të ndihmojë përfshirjen qytetare në vendimmarrje dhe të forcojë kulturën participative politike. Përmes forcimit të vlerave liberale, IDSCS kontribuon në bashkëjetesën e diversiteteve.

## **Detaje për kontakt për Institutin për Demokraci**

Adresa: rr. Miroslav Krlezha nr. 52/1 / 2, 1000 Shkup

Tel. nr./ faks: +389 2 3094 760,

posta elektronike: [contact@idscs.org.mk](mailto:contact@idscs.org.mk)

# INFORMACIONE RRETH NDI-së

Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) është një organizatë që që nga themelimi i tij në vitin 1983 punon për forcimin e demokracisë dhe mbështetjen e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse politike në mbarë botën. NDI është aktiv në Maqedoninë e Veriut që nga viti 1993, duke bashkëpunuar me qytetarët, shoqërinë civile, partitë politike, mediat dhe institucionet për të ndërtuar praktika demokratike më transparente, të përgjegjshme dhe të qëndrueshme. Sot, NDI zbaton Programin për Mbështetje Parlamentare dhe iniciativat “Komunitete me Integritet”, të mbështetura nga qeveritë e Zvicrës dhe Suedisë, me qëllim të avancimit të qeverisjes demokratike dhe integritetit në nivel kombëtar dhe lokal. .

## **Të dhënat e kontaktit për NDI**

Address: 13 Lazar Lichenoski Street, 3rd Floor, 1000 Skopje

E-mail: [ndimacedonia@ndi.org](mailto:ndimacedonia@ndi.org)



